



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6641/2025

A.nr.1565/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj -Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1565/2025, të datës 08.08.2025, të parashtruar nga ankuesja, Xh.J, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1565/2025, të datës 08.08.2025, të parashtruar nga ankuesja, Xh.J.

A r s y e t i m

Ankuesja, Xh.J (në tekstin e mëtejme referuar: ankuese), me datë 08.08.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 08.08.2025 nën shenjën A.nr.1565/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017336, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, ky i fundit, ka dorëzuar më datë 22.09.2025 përgjigjen ndaj ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017336, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, numri i kërkuar një (1), klasa profesional 1, ma afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017336 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 11.07.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja F.P, është vlerësuar me gjithsejtë 81 pikë.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr. 1498/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1498/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN0001336, për pozitën Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Pejës, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1565/2025, të datës 08.08.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1565/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Xh.J;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.